RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të vendimit të Bordit të Radio Televizionit të Kosoës, datë 23.07.2018, dhe duke u mbështetur në nenin 29, të ligjit të RTK-sqë, nr.04/L- 46, më poshtë janë vendimet, konkluzat dhe rekomandimet e mbledhjes së Bordit, të datës 24.08.2018:

1. **Bordi i RTK-së miratoi unanimisht procesverbalin e datës 23.07.2018;**

2. **Bordi i RTK-së mori vendim që, me qëllim të racionalizimit të mjeteve financiare, t'u ndalohet përdorimi i veturave zyrtare jashtë orarit të punës të gjithë punonjësve të RTK-së, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme. Ky vendim nuk vlen për Drejtorin e Përgjithshëm;**

3. **Bordi i RTK-së i rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm, që të merrë masa ndaj të gjithë të punësuarve të RTK-së, të cilët bëjnë shkeljen e Rregullores për Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programet e RTK-së, respektivisht Nenet 23.3, 23.5, 23.7 si dhe Rregullores për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore neni 7 pikat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4;**

4. **Bordi i RTK-së vendosi për ndryshim-plotësimin e nenit 36 të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës;**

5. **Bordi i RTK-së vendosi që, në bazë të nenit 36 të Ligjit për RTK-në dhe nenit 29 të Statutit të RTK-së, të hap konkurs për Grupin Këshillues të Publikut.**

Afërdita Maliqi,

Kryetare e Bordit të RTK-së

A. Maliqi

Prishtinë,

24 gusht 2018